

VENDIM
Nr.258, datë 27.2.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA STUDIMI PRANË SHKOLLËS SË LARTË
UNIVERSITARE PRIVATE “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, Tiranë, për hapjen:

- në Fakultetin e Ekonomisë, të programeve të studimit të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, për:

a) administrim publik;

b) marketing;

c) turizëm;

ç) bankë dhe institucione financiare.

- në Fakultetin e Drejtësisë, të programit të studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, në fushën e së drejtës së biznesit.

2. Kohëzgjatja e programeve të studimit të ciklit të parë do të jetë 3 vite. Në përfundim të programeve të studimeve lëshohet diploma e nivelit të parë (DNP) në fushën e arsimimit të kryer.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Sevasti&Parashqevi Qiriazi” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.